



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali - Prishtinë



Nr./Br. 03-116-2362/3

Data / Datum 30-12-2024



REPUBLIKA E KOSOVËS  
QEVERIA

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: IPK/30122024/DI

Datë: 30.12.2024

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektim në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Departamenti i Inspektimit nxjerrë këtë:

### RAPORT I INSPEKTIMIT

<b>Objekti</b>	- Vlerësimi i praktikave patrulluese dhe të ndaljes së mjeteve
<b>Arsyet e inicimit</b>	- Me kërkesë të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave, më 19.12.2024, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj ka autorizuar Departamentin e Inspektimit që të realizojë një inspektim të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar praktikat patrulluese dhe të ndaljes së automjeteve nga ekipet patrulluese të Njësisë Rajonale të Trafikut Rrugor - Gjilan. IPK ka pranuar një ankesë nga një qytetar (B.D), i cili ka shprehur shqetësimet lidhur me praktikën e aplikuar nga Njësia lidhur me vendosjen e pikave të kontrollit, sjelljen e policëve në raport me drejtuesit e mjeteve motorike, rreziqet që mund të rrjedhin nga ndalja e vendosja e mjeteve në vende të pa sigurta, përzgjedhjen e lokacioneve për kontroll të mjeteve, orientimin policor drejt praktikave më tepër gjobitëse se sa parandaluese, etj. Inspektimi ad hoc ka ofruar një mundësi për t'u njohur me praktikën e aplikuar të patrullimit dhe të mbikëqyrjes së trafikut në rrugët që janë në kompetencë të NJRTRR - Gjilan.
<b>Objektivat</b>	- Vlerësimi i praktikave të patrullimit dhe mbikëqyrjes së trafikut, - Identifikimi dhe vlerësimi i masave të sigurisë gjatë patrullimit dhe kontrollit.
<b>Metodologjia</b>	- Gjatë realizimit të punës inspektuese, është përdorë metodologjia si në vijim: (a) Është realizuar takim me Shefin e NJRTRR - Gjilan; (b) Janë kryhen kontrole (këqyrje apo verifikime) gjatë ditës dhe mbrëmjes: të prezencës së patrullave në terren, të vendosjes së pikave të kontrollit të mjeteve dhe masave të sigurisë gjatë ndaljes dhe kontrollit të mjeteve; (c) Janë marrë dokumente, si: orari i patrullimit dhe fletë patrullat.
<b>Subjekti</b>	- Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor - Gjilan
<b>Afatet</b>	- Inspektimi ka filluar më 23.12.2024 dhe ka përfunduar po në të njëjtën ditë (nga ora 09.00 deri në 16.30).
<b>Kriteri - standardi i vlerësimit</b>	- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - Rregullore për Operativë, - Procedura Standarde e Operimit - Njësitë Rajonale të Trafikut Rrugor, - Udhëzuesi për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen e rregullimit e komunikacionit rrugor.

<b>Përgatitur nga</b>	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i inspektimit
<b>Dorëzuar nga</b>	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Datë</b>	- 30.12.2024





Gjetjet	<p>1. Sipas Udhëzuesit në fuqi për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor, kontrollin në komunikacionin rrugor, zyrtarët policor e kryejnë për të siguruar lëvizje të sigurt dhe pa pengesa në trafik, për të konstatuar nëse pjesëmarrësit u përmbahen rregullave të trafikut, për të parandaluar kundërvajtjet dhe shkeljet tjera në trafik dhe për të ndërmarrë masa të parapara ndaj shkelësve të këtyre veprave. Në drejtim të shtimit të masave të sigurisë rrugore, policët patrullues rregullojnë dhe kontrollojnë trafikun rrugor në disa mënyra, përmes patrullimit në këmbë, patrullimin me mjete, vendosjes së pikave të kontrollit dhe ndëshkimit përmes gjobitjes ndaj shkelësve të rregullave. Është e njohur se Policia e Kosovës në disa nivele të organizimit të saj organizon fushën e kontrollit të trafikut rrugor, përfshirë nivelin rajonal përmes njësive rajonale të trafikut dhe atë lokal përmes stacioneve policore. Ky inspektim ka pasur për fokus NJRTRR - Gjilan, si njëri prej tetë (8) njësive rajonale, të angazhuara në kontrollin e trafikut rrugor kryesisht në rrugët magjistrale të vendit tonë.</p> <p>2. Në ditën e 23 dhjetorit të këtij viti, NJRTRR - Gjilan ka aplikuar orari e punës në dy ndërrime, me nga 12 orë brenda ciklit 24 orë (ndërrimi i parë nga 07:00 - 19:00, kurse ndërrimi i dytë nga 19:00 - 07:00 të ditës pasuese). IPK ka verifikuar prezencën e patrullave policore dhe ka vërejtur se ato janë hasur duke operuar brenda zonave të tyre të përgjegjësisë. Në bazë të Orarit të ndërrimit të paradites "B", përgjatë të cilit është kryer edhe ky inspektim, NJRTRR ka operuar me tre (3) patrulla policore me përbërje me nga dy (2) zyrtarë policor secila:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Patrulla e parë "Trafiku 1", me automjetin me targa Police 131 - 08, ka qenë e angazhuar për kontrollin e trafikut në Magjistralen Gjilan - Prishtinë,</li> <li>(b) Patrulla e dytë "Trafiku 2", me automjetin me targa 05 - 108 - GH, ka qenë e angazhuar për kontrollin e trafikut në Magjistralen Gjilan - Ferizaj, dhe</li> <li>(c) Patrulla e tretë "Trafiku 3", me automjetin me targa Police 147-08, ka qenë e angazhuar për kontrollin e trafikut në Magjistralen Gjilan - Kamenicë.</li> </ul> <p>3. Aktivitetet patrulluese<sup>1</sup> brenda zonës së përgjegjësisë, këto patrulla i kanë realizuar duke patrulluar me automjete në lëvizje, duke vendosur pika kontrolli për ndaljen dhe kontrollin rutinor të mjeteve, dhe kur kanë hasur që drejtuesit e mjeteve kanë shkelur rregullat e trafikut rrugor. Në bazë të tre (3) fletë patrullave të ndërrimit të inspektuar del se: janë organizuar 12 pika të kontrollit, janë ndaluar për kontroll 167 mjete dhe janë shqiptuar 46 kundërvajtje ndaj ngasësve, të cilët kanë shkelur rregullat e trafikut rrugor. Patrulla që ka mbuluar magjistralen Gjilan - Kamenicë ka qenë më aktive në shqiptimin e gjobave, ku secili prej policëve patrullues ka shqiptuar mesatarisht nga dhjetë (10) gjoba, përderisa mesatarja për tre (3) patrullat është afërsisht tetë (8) gjoba për polic. Policët e patrullës që ka mbuluar magjistralen Gjilan - Prishtinë kanë shqiptuar mesatarisht nga katër (4) gjoba secili.</p> <table border="1" data-bbox="424 1473 1324 1688"> <thead> <tr> <th colspan="5">Përmbledhje e aktiviteteve të patrullave të NJRTRR- Gjilan (23.12.2024)</th> </tr> <tr> <th>Thirrja</th> <th>Zona</th> <th>Pika të kontrollit</th> <th>Mjete të ndaluara</th> <th>Gjoba të shqiptuara</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Trafiku 1</td> <td>Magjistrale Gjilan - Prishtinë</td> <td>5</td> <td>29</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Trafiku 2</td> <td>Magjistrale Gjilan - Ferizaj</td> <td>3</td> <td>75</td> <td>18</td> </tr> <tr> <td>Trafiku 3</td> <td>Magjistrale Gjilan - Kamenicë</td> <td>4</td> <td>63</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td colspan="2"><b>Totali i aktiviteteve</b></td> <td><b>12</b></td> <td><b>167</b></td> <td><b>46</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>4. Sipas Rregullores për Operativë, për shkak të rreziqeve me të cilat ballafaqohen me rastin e ndaljes zyrtarët policorë duhet të jenë të kujdesshëm dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme të ndaljes, në mënyrë që pjesëmarrësit tjerë në trafik dhe</p>	Përmbledhje e aktiviteteve të patrullave të NJRTRR- Gjilan (23.12.2024)					Thirrja	Zona	Pika të kontrollit	Mjete të ndaluara	Gjoba të shqiptuara	Trafiku 1	Magjistrale Gjilan - Prishtinë	5	29	8	Trafiku 2	Magjistrale Gjilan - Ferizaj	3	75	18	Trafiku 3	Magjistrale Gjilan - Kamenicë	4	63	20	<b>Totali i aktiviteteve</b>		<b>12</b>	<b>167</b>	<b>46</b>
Përmbledhje e aktiviteteve të patrullave të NJRTRR- Gjilan (23.12.2024)																															
Thirrja	Zona	Pika të kontrollit	Mjete të ndaluara	Gjoba të shqiptuara																											
Trafiku 1	Magjistrale Gjilan - Prishtinë	5	29	8																											
Trafiku 2	Magjistrale Gjilan - Ferizaj	3	75	18																											
Trafiku 3	Magjistrale Gjilan - Kamenicë	4	63	20																											
<b>Totali i aktiviteteve</b>		<b>12</b>	<b>167</b>	<b>46</b>																											

<sup>1</sup> Sipas nenit 3 të Rregullores për Operativë, patrullimi është veprim policor, përmes të cilit mbahet rendi e qetësia publike, sigurohet prona, lëvizja e lirë, kontrolli i kufirit, rregullimi i trafikut, parandalimi e zbulimi i veprave penale, kapja e kryesve të veprave penale, si dhe veprime e aktivitete tjera nga fusha e sigurisë, të cilat bëhen nga Policia në zbatim të ligjit.



	<p>vetë zyrtarët policorë të mos rrezikohen<sup>2</sup>. Gjatë inspektimit të patrullave policore, IPK ka monitoruar aktivitetin e patrullave nëse ato gjatë ndaljes së mjeteve respektojnë rregullat dhe procedurat e parapara për ndaljen e tyre, ndarjen e roleve brenda ekipeve patrulluese, si dhe aplikimin e masave të nevojshme të sigurisë. Të tre dokumentet e Policisë së Kosovës, përfshirë Rregulloren për Operativë, Udhëzuesin dhe Manualin e trajnimit i japin rëndësi rregullave dhe metodologjisë së ndaljes së mjeteve, si dhe ndërmarrjes së masave të sigurisë. Inspektimi vë në pah se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndalja e mjeteve shpesh ndodhë të kryhet në distancë të shkurtër dhe me dalje të shpejtuar nga polici patrullues, nga ana e kundërt e shiritit të lëvizjes së mjetit.</li> <li>- Gjatë monitorimit të ndarjes së roleve të policëve, IPK ka vërejtur se kontrolli i mjeteve shpesh nuk është i përbashkët, meqë në pika të kontrollit ndodhë që të ndalet më shumë se një mjet dhe kontrolli të kryhet ndaras dhe paralelisht nga të dy zyrtarët,</li> <li>- Ngasësit shpesh shihen duke mos qëndruar në mjet gjatë periudhës sa shqiptohen gjobat, por duke komunikuar tek mjeti i Policisë edhe me kokën brenda tyre.</li> </ul> <p>5. IPK është interesuar të shoh nga afër nëse këto patrulla gjatë vendosjes së pikave të kontrollit pozicionohen në lokacione të përshtatshme dhe që ofrojnë hapësirë të sigurt për ngasësit dhe vetë policët. Inspektimi vë në pah se ka raste kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- pikat e kontrollit vendosen në vende të pa përshtatshme për kontroll të trafikut, si në rreth rrotullime, trotuare, apo hapësira tjera të ngushta,</li> <li>- pikat e kontrollit vendosen në vende të padukshme, apo pas objekteve.</li> </ul> <p>6. IPK gjithashtu është interesuar të njihet edhe me faktin nëse patrullat policore janë pajisur me pajisjet e nevojshme për ushtrim të mbikëqyrjes së trafikut rrugor. Në këtë drejtim, IPK ka vërejtur se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- policët patrullues tërë kohën bartin jelekët patrullues,</li> <li>- policët patrullues janë të pajisur me pajisje për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjetit (radar) dhe ato janë përdorur gjatë punës,</li> <li>- së paku njëri prej policëve patrullues ka qenë i pajisur me kamerë të trupit,</li> <li>- ekipet patrulluese nuk vendosin kona për krijimin e pikave të kontrollit,</li> <li>- policët patrullues në shumicën e rasteve kur ndalojnë automjetet, përdorin stopin e dorës.</li> </ul>
<b>Përfundime</b>	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit rezultojnë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Patrullat policore janë hasur duke zhvilluar aktivitet patrullues brenda zonave të tyre të përgjegjësisë dhe me ekipe me përbërje sipas planit,</li> <li>2. Patrullat policore janë hasur duke kombinuar metodat e patrullimit, përfshirë patrullimin në lëvizje, vendosjen e pikave të kontrollit, ndaljen dhe kontrollin e mjeteve dhe sanksionimin e kundërvajtësve.</li> <li>3. Me disa përjashtime, janë hasur dobësi lidhur me mënyrën e ndaljes dhe kontrollit të mjeteve, duke mos marrë edhe masat e duhura të sigurisë.</li> <li>4. Me disa përjashtime, janë hasur dobësi lidhur me vendosjen e pikave të kontrollit, të konsideruara shpesh edhe si vende të pa përshtatshme.</li> <li>5. Me gjithë rezultatet pozitive në përdorimin e pajisjeve teknike, nuk është hasur të jenë përdorur konat e sigurisë gjatë vendosjes së pikave të kontrollit.</li> </ol>

<sup>2</sup> Sipas nenit 10, paragrafi 2 i Rregullores për Operativë, me rastin e ndaljes së automjeteve në trafikun rrugor, zyrtarët policorë duhet ta kenë parasysh situatën dhe rrethanat në trafik, si: llojin e rrugës, dendësinë apo frekuencën në trafik dhe urgjencën për ndaljen e automjeteve, në mënyrë që pastaj të përcaktohen për teknikën, taktikat, metodat dhe procedurat të cilat do t'i aplikojnë me rastin e ndaljes së automjeteve.



Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK i rekomandon Shefit të Njësisë Rajonale të Trafikut Rrugor - Gjilan dhe mbikëqyrësve të ekipeve (ndërrimeve) që të ushtrojnë kontrolle mbi ekipet patrulluese për t'u siguruar se ato ndërmarrin veprimet e nevojshme gjatë ndaljes dhe kontrollit të mjeteve, në drejtim të ngritjes së masave të sigurisë.	-I-	Ekipet patrulluese do të vëzhgohen në terren me intensitet më të shtuar sipas rekomandimit të IPK, në vëzhgimin e tyre në mënyrën e ndaljes së mjeteve në rrugë, në drejtim të ngritjes së masave të sigurisë. Vëzhgimi dhe inspektimi i ekipeve patrulluese të NJRKRR-së do të rritet përmes mbikëqyrësve të ndërrimeve dhe menaxhmentit të NJRKRR-së në rrugët nacionale dhe rajonale dhe përpilimi i raporteve mbi inspektimin, për të evituar të metat e gjetura nga IPK. Për këtë do të përpilohet orari i inspektimit gjatë muajit Janar 2025.	Menjëherë
2.	IPK i rekomandon Shefit të Njësisë Rajonale të Trafikut Rrugor - Gjilan dhe mbikëqyrësve të ekipeve (ndërrimeve) që të ushtrojnë kontrolle mbi ekipet patrulluese për t'u siguruar që pikat e kontrollit për ndaljen dhe kontrollin e mjeteve vendosen në vende të përshtatshme dhe në funksion të rrjedhës normale të qarkullimit dhe sigurisë së policëve e pjesëmarrësve në komunikacion.	-I-	Ekipet patrulluese të NJRKRR-së do të inspektohen në rrugë me intensitet më të shtuar edhe në pikat e kontrollit, të njëjtat do vendosen në lokacione të përshtatshme, në funksion të rritjes së sigurisë, për vetë zyrtarët policor, si dhe për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor, në vendosjen e konave në rrugë, me çka drejtuesit e mjeteve të jenë të njoftuar paraprakisht me mundësinë e ndaljes nga ana e ekipeve patrulluese për kontroll rutinë të dokumentacionit, si dhe gjendjen teknike të mjeteve të tyre, me këtë dhe përshtatjen e shpejtësisë së lëvizjes kushteve të rrugës, konform dispozitave pozitive në fuqi dhe krijimin e kushteve më të volitshme në rrugë për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor.	Menjëherë

**P.S:** IPK vlerëson se këto rekomandime duhet marrë parasysh edhe nga të gjitha njësitë tjera rajonale të trafikut rrugor, Njësia për Kontroll të Autostradës dhe stacionet policore të rendit, që mund të kenë dobësi të kësaj natyre. Rekomandimet mund të përmirësojnë performancën dhe profesionalizmin e tyre, të ngritin shërbimin ndaj publikut dhe të rrisin masat e sigurisë për policët dhe pjesëmarrësit në trafik.